

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6849
E mërkurë, 15 mars 2023
çmimi 0.40

Punëtorët e pastrimit pezullojnë punën, rrugët mbubhen me mbeturina

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA NUK KA PRITJE TË MËDHA PËR TAKIMIN E OHRIT, MEGJITHATË SHPREHET E GATSHME PËR ARRITJEN E MARRËVESHJES

FAQE 4-5



Raundi i ri i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të mbahet më 18 mars në Ohër. Kryeministri Albin Kurti dhe presidenti serb Aleksandër Vuçiç, me ndërmjetësimin e BE-së, pritet të

arrijnë marrëveshje për zbatimin e propozimit evropian për normalizimin e raporteve. Presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti kanë folur të hënën për takimin e Ohrit.

Osmani i ka bërë thirrje komunitetit ndërkombëtar t'i bëjë presion Serbisë, duke vlerësuar se ky takim është një momentum jashtëzakonisht i rëndësishëm në procesin e dialogut

PRESIDENTI BIDEN, THIRRJE AMERIKANËVE T'U BESOJNË BANKAVE

FAQE 7



"JAVA E GRUAS": DEMOKRACIA KËRKON ANGAZHIM TË GJITHËMBARSHËM SHOQËROR

FAQE 3



SPORT



DONJETA SADIKU NUK MERR
PJESË NË KAMPIONATIN BOTËROR
PËR SHKAK TË KUSHTËZIMIT
TË SIMBOLEVE SHTETËRORE

F. 10

RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Britania rrit buxhetin për mbrojtjen, 6 miliardë dollarë më shumë për dy vitet e ardhshme

LONDËR, 14 MARS - Kryeministri britanik Rishi Sunak ka premtuar rritjen e shpenzimeve ushtarake për 6 miliardë dollarë gjatë dy vjetëve të ardhshëm, në përgjigje të sulmit të Rusisë në Ukrainë dhe "sfidës epokale" nga Kina.

Rritja buxhetore, pjesë e një rishikimi madhor të politikave të jashtme dhe të mbrojtjes së Britanisë, është sidoqoftë më pak se ç'kishin kërkuar zyrtarët e mbrojtjes.

Sunak ka theksuar se Britania do t'i rrisë shpenzimet ushtarake në nivelin 2.5 për qind të prodhimit të brendshëm bruto "në periudhën afatgjatë", por nuk caktoi një datë për këtë. Aktualisht Britania shpenzon pak mbi 2 për qind të PBB-së dhe drejtuesit ushtarakë dëshirojnë që kjo shifër të rritet në 3 për qind.

Fondet shtesë do të përdoren pjesërisht për t'i plotësuar rezervat me municione të Britanisë, që u përdorën për ta furnizuar Ukrainën për t'u mbrojtur nga Rusia. Një pjesë e fondeve do të shkojë për marrëveshjen Britani-ShBA-Australi për prodhimin e

nëndetëseve me energji bërthamore. "Bota është bërë më e paqëndrueshme, kërcënimet ndaj sigurisë sonë janë shtuar", i tha Sunak kanalit "BBC" gjatë vizitës në Shtetet e Bashkuara. "Është e rëndësishme që të mbrohemi nga këto".

Britania ka hartuar për herë të fundit një kornizë të mbrojtjes, sigurisë dhe politikës së jashtme, i njohur si Rishikimi i Integruar, në vitin 2021.

Qeveria urdhëroi një përditësim në përgjigje të një bote gjithnjë e më të paqëndrueshme. Raporti i ri, i publikuar të hënën, thotë se "ekziston një perspektivë në rritje që mjedisi i sigurisë ndërkombëtare do të përkeqësohet më tej në vitet e ardhshme, me kërcënimet shtetërore që rriten dhe diversifikohen në Evropë dhe më gjerë".

Sulmi rus në Ukrainë në shkurt të vitit 2022 ndryshoi rendin evropian të sigurisë dhe dokumenti i rishikuar thotë se Rusia përbën "kërcënimin më akut për sigurinë e Mbretërisë së Bashkuar".



Britania është gjithashtu gjithnjë e më e shqetësuar për atë që qeveria e quan "sfida përcaktuese epokale e paraqitur nga aktiviteti gjithnjë e më shqetësues ushtarak,

financiar dhe diplomatik i Partisë Komuniste Kineze".

Dokumentet e rishikuar të mbrojtjes thotë se "kudo që veprimet dhe objektivi i deklaruar i Partisë

Komuniste Kineze kërcënojnë interesat e Mbretërisë së Bashkuar, ne do të ndërmarrim veprime të shpejta dhe të fuqishme për t'i mbrojtur ato".

Kina rihapet për të gjithë turistët



PEKIN, 14 MARS - Kina do t'i rihapë kufijtë për turistët dhe do ta aktivizojë sistemin e lëshimit të vizave nga dita e mërkurë, pas një ndalesë trevjeçare të shkaktuar nga pandemia e koronavirusit.

Kina është një prej vendeve të fundit në botë që hap kufijtë për turistët.

Njoftimi i së martës ka ardhur pasi është shpallur "fitorja vendimtare" ndaj pandemisë së koronavirusit, në shkurt të këtij viti.

Prej ditës së mërkurë do të hapen aplikimet për të gjitha llojet e

vizave.

Ndërkohë, për shtetasit e Hong Kongut dhe Makaut do të vlejë një regjim i posaçëm i lëvizjes pa viza në disa rajone kineze.

Kina e ka zbatuar deri vonë një strategji të ashpër të "zero-rasteve me koronavirus", çka ka nënkuptuar izolime dhe testime ditore për koronavirus, me qëllim të parandalimit të përhapjes së tij. Kjo strategji është pezulluar në dhjetor të vitit të kaluar, pas pakënaqësive në rritje të qytetarëve, të cilët kanë

përmendur ekonominë si arsye për ndryshim të politikave. Për koronavirusin e ri është raportuar për herë të parë në dhjetor të vitit 2019 në Vuhan të Kinës.

Organizata Botërore e Shëndetësisë e pati shpallur koronavirusin si pandemi më 11 mars të vitit 2020. Më shumë se 6.7 milionë njerëz kanë vdekur që prej shpërthimit të pandemisë në gjithë botën.

Shtetet e Bashkuara kanë regjistruar numrin më të madh të viktimitave, të përcjella nga India dhe Brazili.

Inxhinierët britanikë do t'i ndihmojnë Turqisë për vlerësimin e dëmit pas tërmeteve

ANKARA, 14 MARS - Inxhinierë strukturorë dhe civilë të Mbretërisë së Bashkuar kanë udhëtuar në Turqi për të ndihmuar në hetimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmetet e fuqishme të muajit të kaluar. Ata janë duke mbledhur të dhëna gjeologjike dhe janë duke kryer vlerësime të detajuara, se pse janë rrëzuar ndërtesat.

Përgjatë punës me kolegët turq janë prezantuar disa shembuj të ndërtimeve të dobëta, përfshirë përzjerjen e guralecëve me beton, çka ndikon në dobësim të forcës ndërtimore.

Por edhe fuqia e madhe e shkatërrimit e ka luajtur rolin e vet. Lëvizjet e tokës kanë qenë aq të

fuqishme në disa zona, sa që i kanë tejkaluar projektimet mbi të cilat janë dizajnuar ndërtesat.


Edhe Turqia është duke kryer hetimet e veta për tërmetin.

Grupi turk përbëhet nga ekspertë të industrisë, si dhe akademikë që kanë kryer hetime për tërmetet e mëdha në tri dekadat e fundit.

Dy ekipet do të kombinojnë gjetjet, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ndërtimit.

Tërmeti 7.8 shkallë i Rihterit e ka goditur jugun e Turqisë dhe një pjesë të Sirisë më 6 shkurt, dhe ndërkohë është raportuar për disa pasgoditje, po ashtu, të fuqishme.

Më shumë se 50 000 njerëz kanë vdekur në Turqi dhe Siri si pasojë e këtyre tërmeteve.



'Java e Gruas': Demokracia kërkon angazhim të gjithëmbarshëm shoqëror

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 MARS - "Barazia dhe gjithëpërfshirja qëndrojnë në themelet e një demokracie që frymon me shpirtin e barazisë. Duke u nisur nga këto premisa dhe duke punuar për t'i jetësuar ato ne i rrisim gjasat për t'u afruar gjithnjë e më afër ndërtimit të një demokracie të qëndrueshme", kështu ka thënë presidentja Vjosa Osmani në edicionin e dhjetë të "Javës së Gruas".

Ajo ka thënë se u bënë dhjetë vjet me "Javën e Gruas", ngjarje kjo e cila ka vlera të çmuara për kontributin e pashembullt në avancimin e pozitës së gruas dhe promovimin e barazisë gjinore në jetën publike në vend.

Osmani ka thënë se demokracia është një rezultat i angazhimit të gjithëmbarshëm shoqëror. "Nëse tentojmë ta zbërthejmë në copëza, demokracia është një tërësi e veprave individuale të cilat kontribuojnë në ndërtimin e së mirës kolektive dhe e cila me mbështetjen e duhur institucionale arrin të përkthehet në promovim të vazhdueshëm të vlerave demokratike, e që përfundimisht rezulton pastaj me fuqizimin e demokracisë së gjithëmbarshme", është shprehur Osmani, duke shtuar se gratë dhe burrat e Kosovës, vajzat dhe djemtë tanë, qytetarët tanë, duke ndjekur ideale të tyre, i kanë dhënë kah historisë së vendit tonë dhe kanë krijuar bazamentin që ka mundësuar ndryshimet. "Ata i kanë dhënë

krah demokracisë", ka thënë presidentja Osmani.

Ajo ka shtuar se çdo përpjekje për avancim të demokracisë mund të jetë e suksesshme vetëm kur të fuqizohet zëri i qytetarëve, i të gjithëve, pa dallim. "I grave dhe burrave, pa dallim. Më pastaj institucionet e kanë për detyrë ta ofrojnë mbështetjen, resurset, por edhe orientimin strategjik, të cilat krijojnë infrastrukturën e nevojshme siç është institucionalizimi pra i veprave individuale. Dhe ky vullnet, ky përkushtim, ekziston sot më shumë se kurrë", ka theksuar Osmani.

Ajo ka thënë se nëse duam demokraci të fortë, atëherë kemi nevojë për qytetarë të fuqizuar. "Kur qytetarëve u krijohen mundësitë për pjesëmarrje e angazhim, niveli i përgjegjshmërisë së institucioneve fillon e rritet gjithnjë më shumë, shtohet transparencja dhe rritet llogaridhënia", është shprehur Osmani.

Ajo ka theksuar se një demokraci e mirëfilltë është një demokraci që kontribuon në mënyrë aktive për përmirësimin dhe avancimin e pozitës së gruas në një shoqëri. "Një demokraci e shëndoshë është një demokraci që frymon mbi parimin e jetësimit të barazisë gjinore", ka pohuar presidentja.

Osmani ka thënë se edhe pse republika jonë është vetëm 15-vjeçare, qytetarët tanë e kanë dëshmuar ndër vite se e kuptojnë rëndësinë esenciale të



përfshirjes së gruas në jetën institucionale e publike. "Në 15 vjet rrugëtim, Kosova mbetet vendi lider në rajon dhe më gjerë me dy gra presidente në historinë e saj të re; me një përbërje parlamentare që shkon përtej kuotës gjinore; me një qeveri ku gratë janë më të përfaqësuara dhe kanë zë më të fuqishëm se kurrë më parë; mbi të gjitha, Kosova është sot vendi që e ka përkushtimin e palëkundur për të avancuar gjithnjë e më shumë barazinë gjinore në vend", ka deklaruar Osmani.

Ajo ka shtuar se në këto dhjetë vjet të Javës së Gruas, NDI-ja ka

arritur t'i prekë jetët e shumë grave e vajzave të cilat nuk kanë pasur mundësinë për të qenë pjesë e diskutimeve, grupeve punuese, e lërë më të jenë pjesë e vendimmarrjes. "Shumë nga ato janë sot në mesin tonë. Ato po e udhëheqin ndryshimin, ato janë vetë ndryshimi. Edhe unë kam filluar nga radha e fundit atje ku jeni sot ulur, pastaj në vitin e dytë jam ulur pak më afër, në vitin e tretë më afër dhe sot flas si presidente e Republikës. Pas disa vjetësh, ju që jeni ulur atje në fund do të jeni këtu, duke iu drejtuar pjesëmarrësve të 'Javës së Gruas' në vend timin", ka thënë Osmani.

Edhe kryeministri Albin Kurti mori pjesë në diskutimin e hapur "Barazia, barabarësia dhe drejtësia" në kuadër të "Javës së Gruas", organizuar nga Instituti Kombëtar Demokratik me mbështetjen e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar dhe të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Ai tha se krahas opinionëve, analizave, kërkimeve e vendimeve në politikëbërje, vlerat janë shumë të rëndësishme, "ndaj besoj se nuk mund të ketë demokraci pa barazi gjinore".

Sa i përket situatës në Kosovë lidhur me barazinë gjinore, kryeministri beson se ajo është duke u përmirësuar dhe se përmirësimi është më i shpejtë se kurdoherë më parë, ndonëse veçoi se ka edhe shumë punë për t'u bërë.

Më tej, ai nënvizoi se nuk mund të kemi barazi shoqërore pa barazi gjinore andaj barazia gjinore është ajo e cila, në fakt, përbën urën e barazisë shoqërore dhe të demokracisë. Kryeministri Kurti theksoi tri çështje që janë shumë të rëndësishme për ecjen përpara sa i përket barazisë gjinore: kultivimi dhe mirëmbajtja e vatrave të solidaritetit gjinor, emancipimi shoqëror me theks tek emancipimi i burrave dhe atë mbase që në fëmijëri të hershme, dhe trajtimi më i thellë i pasojave të luftës.

Kryeministri Kurti foli edhe për universalitetin që vë në spikamë atë që është e përbashkët dhe jo atë që na dallon, dhe për barazinë në kuptimin që, pavarësisht pse jemi të ndryshëm, duhet të jemi të barabartë. "Barabarësia dëshmohe duke qenë pikërisht të ndryshëm. Ti respekton diferencën, por kemi trajtimin e barabartë", ka thënë Kurti.





Kosova nuk ka pritje të mëdha për takimin e Ohrit, megjithatë shprehet e gatshme për arritjen e marrëveshjes

Raundi i ri i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të mbahet më 18 mars në Ohër. Kryeministri Albin Kurti dhe presidenti serb Aleksandër Vuçiq, me ndërmjetësimin e BE-së, pritet të arrijnë marrëveshje për zbatimin e propozimit evropian për normalizimin e raporteve. Presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti kanë folur të hënën për takimin e Ohrit. Osmani i ka bërë thirrje komunitetit ndërkombëtar t'i bëjë presion Serbisë, duke vlerësuar se ky takim është një momentum jashtëzakonisht i rëndësishëm në procesin e dialogut

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 14 MARS - Presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti kanë folur të martën për takimin e radhës që do të mbahet më 18 mars në Ohër në mes të Kosovës dhe Serbisë në kuadër të dialogut për normalizim të raporteve. Presidentja Osmani ka thënë se nuk ka shumë shpresa te qasja e Serbisë në takimin e radhës me Kosovën në Ohër. "Ky do të jetë një takim ku Kosova, si gjithnjë, pa dallim, do të angazhohet me shumë konstruktivitet dhe do t'i japë propozimet e veta. Gjithsecila prej tyre kontribuon

për paqe dhe stabilitet në rajon. Kontribuon për arritjen e një marrëveshje e cila vërtet zgjidh probleme. Prandaj, këto janë pritjet që varen nga ne, megjithatë unë nuk mund t'ju tregoj se si do të sillen Serbia, sepse nuk është që deri sot ata kanë dhënë ndonjë kontribut qoftë për arritje të marrëveshjes apo qoftë për paqe dhe stabilitet në rajon", ka deklaruar Osmani në një deklaratë për medie. Ajo ka thënë se presidenti serb po jep sinjale se ata nuk kanë ndryshuar dhe nuk e kanë ndër mend të ndryshojnë. "Kontributi i tyre i vetëm në këtë proces ka qenë obstrukcioni dhe kjo nuk është asgjë e re, sepse kjo ka

ngjarë në këto 13 vjet të dialogut. Edhe atëherë kur kanë nënshkruar marrëveshje Serbia është kujdesur që të gjejë një mënyrë për mosimplementimin e tyre. Deri më tani më shumë se gjysma e marrëveshjeve të nënshkruara në Bruksel, përfshirë edhe këto të fundit, nuk janë duke u zbatuar nga ana e Serbisë dhe kjo tregon se interesimi i tyre asnjëherë nuk është që të kemi një proces konstruktiv i cili vërtet i kontribuon paqes afatgjatë. Kështu që nuk kemi pritje të mëdha nga ana e Serbisë", është shprehur Osmani.

Megjithatë, ajo pret nga komuniteti ndërkombëtar t'i bëjë presion Serbisë. "Shpresa ime është që komuniteti ndërkombëtar do të fokusohet me një presion në raport me Serbinë, në mënyrë që të bindet edhe Serbia që takimi i cili do të ndodhë në Ohër më 18 mars është një momentum jashtëzakonisht i rëndësishëm në procesin e dialogut. Përmes kësaj marrëveshjeje, bashkë me një plan zbatim, të zgjidhen shumë çështje, që më pas hapin dyert drejt njohjes reciproke", ka thënë Osmani.

Presidentja e vendit ka folur edhe për 15 modelet e prezantuara për

Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. "Modelet të cilat janë prezantuar, pra të 15-at, nuk kanë të bëjnë me Asociacionin. Janë modele të drejtash për pakicat, pra janë modele të cilat disa japin më shumë të drejta. Në disa prej tyre ka më pak të drejta sesa që tashmë Kosova ua jap komuniteteve joshumicë. Ne i kemi analizuar të gjitha këto modele dhe natyrisht ka elementë që mund të merren nga secila prej tyre, por unë mund t'ju them se modeli më i mirë sesa ato 15 modele është modeli aktual që ka Republika e Kosovës", është shprehur Osmani.

Ajo ka thënë se pala e Kosovës është e gatshme të diskutojë për çfarëdo modeli që ruan sistemin tonë kushtetues. "Ne jemi aty për të diskutuar elementë të tilla, në mënyrë që në Kosovë të kemi gjithëpërfshirje, diversitet të vazhdueshëm që multietniciteti të vazhdojë të jetë vlera kryesore e sistemit tonë kushtetues. Pra gjithçka që mund të bëjmë është që të garantojmë të drejta përdoruesit nuk cenohet funksionaliteti i brendshëm i shtetit tonë", ka deklaruar presidentja Osmani.

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se është optimist për

takimin e radhës me Serbinë që zhvillohet në Ohër, por që nuk varet gjithçka nga ai. "Unë jam optimist, por tash se a do të ketë sukses apo jo e dini që nuk varet prej meje. Unë kam ofruar që edhe më 27 shkurt në Bruksel ta nënshkruajmë propozimin e Bashkimit Evropian, mirëpo pala tjetër nuk ka qenë as e gatshme, as e interesuar", ka thënë ai.

Kurti ka thënë se e kupton qëndrimin e Serbisë, por "duhet referuar asaj që jemi marrëveshje" dhe që "plani i zbatimit duhet të negociohet në Ohër e, mbase, jo vetëm në Ohër". "Le ta diskutojmë planin e zbatimit. Unë e kuptoj që Serbia shtyn shumë për çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ajo është në nenin 10 njëra prej 33 marrëveshjeve. Në fakt, kur kam shikuar tash së fundi, bashkë me konkluzionet që janë bërë në Bruksel, del që nga 2 korriku i vitit 2011, deri më 25 gusht të vitit 2015, janë 39 marrëveshje gjithsej, dhe Asociacioni përbën gjashtë pikat e para të një marrëveshjeje 15-pikëshe, e cila është e 16-ta prej 39", është shprehur Kurti.

Një ditë më parë Kurti ka thënë se është duke i analizuar 15 modelet evropiane që i ka ofruar Bashkimi

Konjufca dhe drejtoresha e NDI-së nënshkruajnë memorandum mirëkuptimi

PRISHTINË, 14 MARS - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të martën në takim drejtoreshën e Institutit Kombëtar Demokratik (NDI), Nancy Soderberg. Gjatë takimit u bisedua për projektet e deritanishme të NDI-së dhe aspektet e zgjerimit të bashkëpunimit të ndërsjellë në të ardhmen, me fokus në fushën e transparencës, hulumtimeve parlamentare dhe ngritjen e kapaciteteve ligjvënese. Me këtë rast u nënshkrua edhe memorandum i mirëkuptimit në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) në Kosovë në lidhje me themelimin e Institutit Parlamentar, avancimin e mbikëqyrjes dhe transparencën në Kuvend. Konjufca shprehu mirënjohje për

rolin dhe kontributin e çmuar të NDI-së në drejtim të konsolidimit dhe forcimit të kapaciteteve legjislative dhe institucioneve demokratike shtetërore, duke rritur gatishmërinë e Kuvendit për shtimin e bashkëpunimit. Ai vuri në dukje se në sajë bashkëpunimit të ngushtë të stafit të kabinetit dhe atij të NDI-së është arritur mbështetja më e madhe deri më tani për Kuvendin nga ky Institut dhe USAID-i.

Nga ana e saj, drejtoresha Soderberg e falënderoi kryetarin e Kuvendit për pritjen dhe vuri theksin në rëndësinë e vazhdim të bashkëpunimit me Kuvendin dhe institucionet e tjera, në funksion të efikasitetit dhe fuqizimit të legjislativit, si dhe forcimit të demokracisë në Republikën e Kosovës.



Qëllimi i përgjithshëm i memorandumit është ta fuqizojë barazinë gjinore, qeverisjen llogaridhënëse dhe integritetin e informacionit.

Projekti synon të ofrojë asistencë teknike të bazuar në hulumtim dhe në formë strategjike t'i kontribuojë përkrahjes së avancimit të gjithëpërfshirjes,

leadershipit politik të grave, t'i avancojë shërbimet profesionale të Kuvendit, transparencën parlamentare dhe mbikëqyrjen e ekzekutivit.



Gjermania pret marrëveshje në Ohër për zbatimin e propozimit evropian

Gjermania pret që në raundin e ri të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë që mbahet në Ohër më 18 mars palët do të arrijnë marrëveshje për zbatimin e propozimit evropian për normalizimin e raporteve. Ambasada gjermane në Beograd i tha "Radios Evropa e Lirë" se avancimi drejt integritimit evropian të shteteve të Ballkanit Perëndimor është synim i Procesit të Berlinit, por në rastin e Kosovës dhe Serbisë ka një pengesë në këtë rrugë. "Raportet e pazgjidhura në mes të Kosovës dhe Serbisë vazhdojnë të paraqesin pengesë. Takimi i ri i nivelit të lartë në Ohër shënon një hap të rëndësishëm drejt tejkalimit

të kësaj pengese dhe avancimit në rrugën evropiane", thanë nga Ambasada gjermane. Në takimin e Ohrit palët pritet të diskutojnë për planin e zbatimit të propozimit të BE-së.

Sipas Berlinit zyrtar, propozimi evropian për normalizimin e raporteve, për të cilin ranë dakord më 27 shkurt kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vučić, synon të krijojë një bazë të qëndrueshme dhe të besueshme për raportet mes dy shteteve. "Që kjo të ketë sukses, të dyja palët duhet të pajtohen që ta zbatojnë marrëveshjen", thanë nga Ambasada gjermane në përgjigjen dërguar REL-it.

Evropian për formimin e Asociacionit. "Unë besoj se ato janë modele nga të cilat ne do të mund të marrim elemente në mënyrë që jo vetëm të drejtat e njeriut, por edhe të drejtat e pakicave kombëtare të jenë në nivelin e duhur edhe në vendin tonë. Ato po trajtohen nga këshilltarët e mi, nga disa prej ministrave, në mënyrë që ta shohim se çka është më e favorshme. Natyrisht, kushtetutshmëria, ligjshmëria, barazia, funksionimi i shtetit janë diçka me të cilat ne nuk bëjmë asnjëherë askund kompromis", ka thënë Kurti për gazetarët.

I dërguari i BE-së për Ballkanin Perëndimor, Mirosllav Lajçak, ka thënë se këto modele janë në përputhje me standardet evropiane. Asnjëra prej 15 modeleve evropiane nuk janë bërë publike, as nga Kosova e as nga Brukseli.

I dërguari i Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, Mirosllav Lajçak, ka thënë për Radiotelevizionin e Serbisë (RTS), se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe duhet të formohet në Kosovë, pasi "nëse nuk ka Asociacion, nuk ka marrëveshje". Sipas tij, Asociacioni është parakushti kryesor për zbatimin e

propozimit evropian. Dokumenti prej 11 nenesh që është bërë publik nga Bashkimi Evropian nuk përmend në mënyrë specifike njohjen e ndërsjellë që Qeveria e Kosovës ka thënë se duhet të jetë në qendër të një marrëveshjeje eventuale për normalizim të raporteve. Megjithatë, në nenin 2 të propozimit përmendet që

palët duhet ta respektojnë pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të njëra-tjetres. Propozimi, po ashtu, përfshin zotimin e palëve për t'i respektuar të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve si dhe përkushtimin e tyre për të mos e penguar njëra-tjetrën në

proceset integruese. Kosova dhe Serbia i kanë nisur negociatat e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian më 2011. Tani për tani të dyja vendet kanë synime të ndryshme për marrëveshjen finale. Kosova insiston në njohje reciproke, Serbia kërkon zgjidhje kompromisi.

Shefja e BE-së: Kosova dhe Serbia ta shfrytëzojnë rastin për normalizim

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, i ka ftuar të martën Kosovën dhe Serbinë që ta shfrytëzojnë propozimin e Bashkimit Evropian për t'i normalizuar marrëdhëniet. Në një takim me korrespondentët e agjencive evropiane të lajmeve, von der Leyen ka thënë se pret që

këto dy vende ta shfrytëzojnë rastin në takimet e radhës, ashtu që të japin kontribut për stabilitetin e rajonit si dhe në rrugëtimin e tyre drejt BE-së. "Kemi një plan të Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Mendoj

se ai përbën një rast për të dyja palët që ta shfrytëzojnë momentumin, sepse normalizimi është kyç për sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin e rajonit", ka thënë shefja e BE-së. E pyetur se cilat do të jenë pasojat nëse nuk arrihet ndonjë marrëveshje në mes të Kosovës

dhe Serbisë në këto takime, ajo ka thënë se "së pari duhet zhvilluar negociatat, pastaj duhen parë rezultatet". Ajo ka thënë se pret që palët të jenë konstruktive në takimet e radhës. "Shpresoj që të dyja palët do të jenë shumë konstruktive në takimet që do të zhvillohen së shpejti".

Pasi nisin punimet në restaurimin e gjimnazit "Ismail Qemali" në Ferizaj, i vihët flaka

FERIZAJ, 14 MARS - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka bërë me dije se, pasi kanë filluar punimet në restaurimin e gjimnazit të vjetër "Ismail Qemali" në Ferizaj, të martën në orët e para të mëngjesit i është vënë flaka. "Kontratën për restaurimin e

gjimnazit të vjetër e patëm nënshkruar javën e kaluar. Dje kanë nisur punimet, ndërsa sot në orët e para të mëngjesit ia vunë flakën. Ky është krim. Përgjegjësit duhet të përballen me drejtësinë", ka shkruar Çeku në "Facebook". Ai ka theksuar se gjimnazi i

vjetër "Ismail Qemali" në Ferizaj do të restaurohet, u pëlqeu apo jo keqbërësve. "Trashëgimia jonë kulturore është më e rëndësishme se interesat tuaja të ngushta. Metodën e porositë mafioze nuk na ndalin", ka shkruar ministri Çeku.



Përurohen investimet për eficiencë të energjisë në dy objekte në Malishevë

MALISHEVË, 14 MARS - Komuna e Malishevës është një prej komunave që ka përfunduar disa projekte në kuadër të masave për eficiencë të energjisë, ku në kuadër të zbatimit të këtyre masave tashmë janë përfunduar dy objekte në të cilat kanë përfunduar punimet, objekti i komunës dhe objekti i gjimnazit "Hamdi Berisha" në Malishevë. Në përfundimin e këtyre dy objekteve ka marrë pjesë drejtori menaxhues i Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE), Ahmet Ismaili, zëvendësministri për Ekonomi, Getoar Mjeku, zëvendëshefi i bashkëpunimit të Zyrës së BE-së në Kosovë, Alessandro Bianciardi, si dhe përfaqësuesi i Bankës Botërore, Redon Begolli, të cilët janë pritur nga kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, me bashkëpunëtorë. Kastrati i ka pritur në takim

përfaqësuesit e këtyre institucioneve të cilët i ka falënderuar për bashkëpunimin dhe përkrahjen për realizimin e këtyre projekteve në komunën e Malishevës. Edhe përfaqësuesit e FKKE-së, Ministrisë së Ekonomisë, BE-së dhe Bankës Botërore e kanë falënderuar dhe e kanë përgëzuar kryetarin Kastrati për bashkëpunimin e mirë për realizimin e këtyre projekteve dhe se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në fazat e tjera të realizimit të projekteve në kuadër të masave për eficiencë të energjisë. Më pas, të gjithë së bashku e kanë bërë përfundimin e këtyre dy objekteve dhe i kanë parë nga afër investimet dhe realizimin e tyre, në izolim, ngrohje dhe ndriçim, pjesë e masave për eficiencë të energjisë, të cilat tashmë kanë ulur përgjysmë



koston e shpenzimeve në këto objekte. Shuma investuese në këto dy

objekte është mbi 420 mijë euro, ndërsa përfitues parashihet të jenë komuna e Malishevës,

nxënësit, personeli i kësaj shkolle, mbi të gjitha gjithë qytetarët e Malishevës.

Punëtorët e pastrimit pezullojnë punën, rrugët mbulohen me mbeturina



PRISHTINË, 14 MARS - Punëtorët e Ndërmarrjes "Pastrimi" të hënën kanë protestuar në lidhje me kushtet e punës, derisa kanë njoftuar se nuk do të dalin në terren deri në plotësimin e kërkesave të tyre. Ata kanë kërkuar nga bordi i KRMM "Pastrimi" rritje të pagës për 70 euro dhe përmirësim të kushteve të punës në terren. Kjo ndërmarrje u ka propozuar punëtorëve rritje të pagës prej 30 eurosh në muajt në vazhdim,

por me këtë nuk janë pajtuar punëtorët dhe kanë vazhduar deri në plotësimin e kërkesave të parashtruara. Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se e kupton zhgënjimin e punëtorëve dhe njeh të drejtën e tyre për të protestuar, por vendimi i tyre për ta ndërprerë punën ka pasur një ndikim të rëndë në pastërtinë e qytetit tonë. "Rrugët janë të mbushura me mbeturina dhe kjo situatë është e

papranueshme. Ne kemi qenë aktivisht të angazhuar me ndërmarrjen për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje dhe jemi të përkushtuar për të arritur një marrëveshje të drejtë nga e cila do të përfitojnë edhe punëtorët dhe kryeqyteti. Ndërkohë, ne jemi duke vendosur të gjitha burimet në dispozicion për ta menaxhuar situatën dhe për t'i pastruar sa më shpejt mbeturinat", ka thënë Rama.

Nis projekti për krijimin e rrugëve më të sigurta për fëmijët në kryeqytet

PRISHTINË, 14 MARS - Komuna e Prishtinës ka njoftuar për nisjen e një projekti të ri që synon krijimin e rrugëve më të sigurta për fëmijët në kryeqytet. "Nëpërmjet projektit 'Rrugët për fëmijë' do të krijojmë një mjedis më të sigurt dhe të këndshëm për fëmijët në hapësirat përreth shkollave të tyre. Pas disa muajsh analizë, matje, projektim, planifikim e takime me qytetarë, ju njoftojmë se punimet do të fillojnë të

enjtën, me datë 16 mars 2023, duke nisur me hapësirat përreth ShFMU 'Elena Gjika', ka njoftuar komuna e Prishtinës. Sipas këtij njoftimi, nga kjo ditë rruqa që prej Bulevardit "Zejnel Saliu" nga udhëkryqi i rrugës "Emin Duraku" deri te kryqëzimi me rr. "Ernest Koliqi" do të mbyllet përherë për qarkullimin e mjeteve motorike. "Sigurisht, me përjashtim të veturave të emergjencës, zjarrfikësve dhe

veturave të policisë, veturave zyrtare dhe ato të parapara me ligj - për të cilat do të ketë pistona lëvizës që mundësojnë qarkullimin në raste emergjente. Ne besojmë se me këto intervenime mund të bëjmë një ndryshim të rëndësishëm në jetën e banorëve tanë më të rinj, dhe të njëjtin koncept do ta aplikojmë edhe në rrugët e tjera përreth të gjitha shkollave të kryeqytetit", ka njoftuar komuna e Prishtinës.



Ambasadori Minxhozi viziton drejtorin e ri të Policisë së Kosovës

PRISHTINË, 14 MARS - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, ka pritur në takim ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi.

Ambasadori Minxhozi e uroi drejtorin për pozitën si dhe rikonfirmoi bashkëpunimin

dhe përkrahjen e Ambasadës për Policinë e Kosovës.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, ka falënderuar ambasadorin për përkrahjen e deritanishme dhe ka theksuar se Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për

përmbushjen e objektivave të saj duke u angazhuar në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi ligjore në funksion të sigurisë së përgjithshme. Ata u zotuan dhe shprehën gatishmërinë për avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të ndërsjellë.



Rasti Ivanoviq: Dëshmitarët s'paraqiten në seancë për shkak të 'situatës politike'



PRISHTINË, 14 MARS - Seanca në Gjykatën Themelore në Prishtinë për rastin e vrasjes së politikanit të opozitës serbe nga Kosova, Oliver Ivanoviq, është shtyrë për 25 maj për shkak se dëshmitarja Milena Popoviq nuk është paraqitur. Kjo nuk është hera e parë që seanca shtyhet për shkak të mosparaqitjes në gjykatë të Milena Popoviqit, bashkëshorte e pakurorëzuar e Oliver Ivanoviqit.

Prokurori Burim Qerkini vlerësoi se procesi gjyqësor po vonohet për shkak të kësaj dëshmitareje dhe sugjeroi që gjykimi të vazhdojë pa të. Megjithatë, gjyqtari Valon Kurtaj ka bërë me dije se trupi gjykues ka marrë vendim që edhe një herë të tentohet të merret deklarata nga Popoviqi përmes videolidhjes, të cilën ajo e ka kërkuar nga gjykata që t'ia lejojë.

Në një njoftim me shkrim drejtuar gjykatës më 4 mars, ajo deklaroi se nuk mund të merrte

pjesë në seancë "për shkak të situatës aktuale politike".

Gjykatësi Kurtaj tha se deklarata e Milena Popoviqit duhet të merret përmes Departamentit për Ndihmë Juridike Ndërkombëtare, i cili funksionon në kuadër të misionit EULEX (Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit).

Ministria e Drejtësisë e Kosovës dhe ajo e Serbisë nuk bashkëpunojnë, prandaj në këtë rast nevojitet ndërmjetësimi i EULEX-it për marrjen e deklaratave të dëshmitarëve.

Avokati mbrojtës, Dejan Vasiq, ka theksuar se "një numër i madh i seancave kryesore janë shtyrë për shkak të mungesës së Milena Popoviqit" dhe është pajtuar me prokurorinë se dëshmia e saj nuk ka qenë vendimtare për rastin e vrasjes së Oliver Ivanoviqit. "Ka mbetur ende shumë pak punë në lëndë, edhe dy dëshmitarë të propozuar nga mbrojtja, që të dëgjohen nga vetë të dyshuarit.

Pres që fjalët përfundimtare të jenë në qershor në procedurën e shkallës së parë", tha Vasiq.

Ai më parë i kërkoi gjykatësit që të mos lejojë që "shqyrtimi kryesor të shndërrohet në hetim për vrasjen e Oliver Ivanoviqit". Sipas mendimit të tij, dëshmitarët që janë paraqitur në gjykatë deri më tani janë marrë në pyetje sikur hetimi është ende në vazhdim dhe shtoi se asnjëri prej tyre nuk i ka përmendur personat e cekur në aktakuzë.

Më 14 mars trupi gjykues vendosi t'i dëgjojë edhe dy dëshmitarë të tjerë me sugjerimin e avokatit Faruk Korenica i cili mbron Nedelko Spasojeviqin.

I akuzuari Spasojeviq tha se edhe dëshmitarët potencialë kërkuar pak kohë për shkak të "situatës politike". Bëhet fjalë për ish-policët e Kosovës të cilët janë larguar nga pozitat e tyre në kuadër të daljes kolektive të serbëve nga institucionet e Kosovës në veri.

Me vrasjen e Oliver Ivanoviqit janë të lidhur edhe Zhelko Bojiq (ish-shefi i operacioneve të Policisë së Kosovës për rajonin e veriut), Milan Radoiçiq (nënkryetar i Listës Serbe) dhe Zvonko Veselinoviq (biznesmen). Ndaj tyre nuk është ngritur aktakuzë sepse ata ishin në arrati kur Prokuroria e Kosovës ngriti aktakuzën e parë.

Radoiçiqi dhe Veselinoviqi përmenden në aktakuzë si "udhëheqës të grupit kriminal", i cili planifikoi vrasjen e politikanit Oliver Ivanoviq. Megjithatë, urdhërrresti për Milan Radoiçiqin u tërhoq në mars të vitit 2021 pa asnjë shpjegim.

Prokuroria Speciale e Kosovës deri më tani ka ngritur tri aktakuza, por në to nuk ka pasur ndryshime thelbësore, gjegjësisht përmenden vetëm personat që "me vetëdije dhe qëllim kanë ndihmuar grupin kriminal për kryerjen e veprës penale të vrasjes së Oliver

Ivanoviqit", por jo autori i vrasjes apo porositësi.

Aktakuza e parë është ngritur në fillim të dhjetorit 2019, ndërsa në fund të dhjetorit të po atij viti prokurori i atëhershëm, Sylë Hoxha, ka paraqitur aktakuzën e dytë të ndryshuar. Më pas, në nëntor 2020, u ngrit aktakuza e tretë dhe pasi Gjykata e Apelit në Prishtinë e ktheu aktakuzën e mëparshme për ndryshim.

Oliver Ivanoviqi është vrarë më 16 janar 2018, me gjashtë të shtëna në shpinë, para objekteve të partisë së tij në Mitrovicën e Veriut. Ai ishte bartës i listës "Liria, demokracia, drejtësia" në zgjedhjet lokale të Kosovës, të cilat u mbajtën në nëntor të vitit 2017, disa muaj para vrasjes së tij.

Gjatë fushatës parazgjedhore për ato zgjedhje lokale, për shkak të frikësimit të serbëve në veri të Kosovës, katër kandidatë nga lista e tij u tërhoqën dhe iu dogjën veturat në veri të Mitrovicës. /REL/

Kurti pranoi draftin e Projektligjit për Fondin Sovran

PRISHTINË, 13 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka takuar grupin e ekspertëve të ngarkuar me hartimin e Projektligjit për Fondin Sovran.


Grupi i ekspertëve, i udhëhequr nga koordinatori Rrezarta Pllana, e informoi kryeministrin Kurti lidhur me

punën intensive për hartimin e projektligjit, përfshirë këtu takimin me përfaqësuesit e fondeve investive nga Greqia e Sllovakia.

Projektligji për Fondin Sovran të Republikës së Kosovës është publikuar tashmë në platformën e konsultimeve, i qasshëm për lexim dhe

komentim të publikut dhe palëve të interesuara.

Fondi Sovran do të administrojë ndërmarrje e asete të republikës me potencial zhvillimor, duke përmirësuar qeverisjen dhe duke rritur vlerën e tyre, me synim zhvillimin e vendit dhe mirëqenien e qytetarëve.



78 për qind e eksportit të Kosovës në kategorinë e pijeve realizohet nga kompania "Frutex"

SUHAREKË, 14 MARS - Shaqir Palushi, pronar i kompanisë "Frutex" nga Suhareka, ka bërë me dije se 78 për qind e eksportit të Kosovës në kategorinë e pijeve realizohet nga kompania "Frutex". Brendet "Golden Eagle", "Natural" dhe "Relax" mbyllën vitin 2022 me një ndër produktet më të eksportuara jashtë vendit.

"Gjatë vitit 2022 'Frutex' ka pasur rritje të eksportit për 20 për qind, kurse pjesëmarrja e kompanisë me brendet 'Golden Eagle', 'Relax' dhe 'Natural' në kategorinë e pijeve joalkoolike të eksportuara nga Kosova ishte mbi 78 për qind. Këto shifra e bëjnë 'Frutex' kompani lidere të eksportit në vendin tonë, kurse brendin 'Golden Eagle' produktin më të shitur shqiptar", ka shkruar Shaqir

Palushi në "Facebook". Tashmë produktet e kompanisë "Frutex" eksportohen në mbi 30 vende të botës: Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi, Serbi, Bosnje-Hercegovinë, Slloveni, Itali, Zvicër, Gjermani, Suedi, Angli, Belgjikë, Holandë, Bullgari, Çeki, Austri, Luksemburg, Francë, Austri, Finlandë, Kuvajt, Irak, Libi, Kenia, ShBA, Australi, Indi etj.



Presidenti Biden, thirrje amerikanëve të kenë besim te bankat



WASHINGTON, 14 MARS - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden, ka thënë se sistemi financiar amerikan është i sigurt, në një përpjekje për të injektuar besim, pas falimentimit të dy bankave. Ky zhvillim nxiti frikë për pasojat më të mëdha. "Depozitat tuaja do të jenë aty kur t'ju nevojiten", ka thënë presidenti Biden.

Të premten që lamë pas entet

rregullatore amerikane mbyllën bankën "Silicon Valley", ndërsa ajo u përball me mungesë të parash, ndërsa klientët nxituan t'i tërheqin depozitat e tyre për shkak të shqetësimeve lidhur me aftësitë paguese të bankës. Ky është falimentimi i dytë më i madh në historinë e vendit, pas asaj që ndodhi me bankën "Washington Mutual" në vitin 2008, e cila, gjithashtu, nuk arriti t'i përmbushë detyrimet

financiare. Pas bankës "Silicon Valley", edhe një bankë e dytë, "Signature", me bazë në Nju-Jork, gjithashtu falimentoi. Duke folur nga Shtëpia e Bardhë, presidenti Biden tha se do të kërkojë që përgjegjësit të japin llogari, ndërsa ushtroi trysni për mbikëqyrje e praktika më të mira që rregullojnë veprimtarinë e bankave më të mëdha. Presidenti premtoi se asnjë humbje nuk do të përballohet

nga taksapaguesit. "Amerikanët mund të kenë besim se sistemi bankar është i sigurt", ka pohuar ai. Biden njoftoi, gjithashtu, për shkarkimin e drejtuesve të bankave që falimentuan. "Nëse banka do të administrohen nga Korporata Federale e Sigurimit të Depozitave, ata që drejtojnë bankën nuk duhet të punojnë më atje", ka thënë ai. Korporata Federale e Sigurimit të Depozitave është agjencia

përgjegjëse federale për sigurimin e stabilitetit të sistemit bankar. Me një vlerë kapitali prej 110 miliardë dollarësh, falimentimi i bankës "Signature" përbën rastin e tretë më të madh në historinë e ShBA-së. Një tjetër bankë në vështirësi, "First Republic", njoftoi të dielën se kishte forcuar situatën e saj financiare falë financimit të siguruar nga Banka Qendrore dhe "JPMorgan Chase".

Rritet besueshmëria e opinionit ndaj ATK-së

PRISHTINË, 14 MARS - Vazhdon perceptimi pozitiv ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) përmes raporteve me relevancë të institucioneve ndërkombëtare. Një vlerësim i tillë u bë së fundi nga Përmbledhja e Pulsit Publik XXIII, të përgatitur nga UNDP, në të cilin në pjesën e perceptimeve për përhapjen e korrupsionit në institucionet e vendit, ATK-ja radhitet në nivel të favorshëm. Në indeksin e krahasimeve i cili

matë perceptimin për nivelin besueshmërisë ndaj ATK-së për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022, rezultoi se institucioni i ATK-së ka shënuar rënie të ndjeshme të opinionit publik për praninë e korrupsionit në ATK. Treguesit matës prezantuan se ATK-ja ka shënuar progres sa i përket integritetit të saj në raport me qytetarët, kështu që nga prilli 2022 në nëntor 2022 ka rënie në 24.10 për qind nga 25.40 për qind.

Vlen të theksohet se nga 40 për qind sa ka qenë në vitin 2019, në 2022 ka 24.10 për qind rënie. Këta tregues janë reflektim i angazhimit të menaxhmentit të lartë dhe stafit të ATK-së për forcimin e partneritetit të institucionit me qytetarët për të cilën ATK-ja ka krijuar dhe vazhdon të krijojë mekanizma në rritjen e besimit ndaj ATK-së për raportimin e rasteve korruptive dhe çfarëdo sjellje tjetër e cila dëmton tatimpaguesit dhe qytetarët.



Identitetin e letërsisë shqipe e përcakton gjuha

Intervistë me shkrimtarin Bashkim Shehu



Intervistoi:
Ardit MEHMETAJ

Mario Vargas Llosa, kur e interviston Gabriel García Márquezin, pyetjen e parë ia bën: "Për çfarë, sipas jush, duheni ju si shkrimtar?". Po t'jua bënte Llosa këtë pyetje, cila do të ishte përgjigja juaj?

Përgjigja më e mirë, për mendimin tim, është ajo që ka dhënë para njëzet e tre shekujsh Aristoteli, se arti nuk i shërben asgjëje dhe se, njëkohësisht, është gjëja më e vyer. Do të shtoja, nga vetja, diçka edhe më arrogante: çështja nuk është se për çfarë duhem, po është se kështu dua, apo më saktë nuk mund të mos dua.

Sie kaluat kohën e karantinimit? Çfarë bënit?

Këtu në Spanjë patëm 48 ditë karantinë, gati-gati arrest shtëpie. Gjatë asaj periudhe kam përkthyer, jam marrë me përgatitjen e një numri të një reviste kulturore online dhe, gjithashtu, konceptova romanin që jam duke shkruar tani.

Cila është sfida e të qenit shkrimtar në ditët e sotme?

Mendoj se një nga sfidat për shkrimtarin, dhe kryesorja, është ajo

që ka qenë gjithmonë: të shkruajë mirë. Ndërkaq, ekzistojnë edhe sfida të tjera, më specifike, që ndryshojnë jo vetëm nga një kohë në tjetrën, po edhe nga një vend në tjetrin. Për vende si Shqipëria, apo si Spanja, si dhe për vende të ngjashme, është ajo e përballjes me komercializimin e theksuar të kulturës gjë që, në fund të fundit, lidhet me sfidën e përhershme, pra me cilësinë e të shkruarit.

Shkrimtari katalunas Javier Cercas ka një prije të shkruajë romane pa fikson, tipar ky pak a shumë i njëjtë me mënyrën tuaj të shkrimit. Nga buron dëshira për të shkruar romane pa fikson?

Ato lloj tekstesh përbëjnë një pjesë të vogël në krijimtarinë time dhe kam njëzet vjet që nuk shkruaj të tilla. Në ato raste ndodhitë reale i ngjajnë fiksonit: pikërisht kjo më shtyu që t'i shkruaja. Por kjo ngjashmëri shfaqet rrallë, ose shquhet rrallë, prandaj u bë kohë që nuk shkruaj më të tilla. Ndërkohë, kam ndjekur një rrugë tjetër, paraqitjen e fiksonit si ndodhi reale, po gjithsesi duke vënë poshtë titullit fjalëzën "roman", çka përbën licencën për të trilluar.

Shumë prej veprave tuaja qëndrojnë në mes të vërtetës dhe trillit. Të tilla janë "Vjeshta e ankthit",

"Loja, shembja e qiellit", "Liri Belishova dhe koha e saj" e të tjera, ku ju bëni gërshetim mjaft të arrirë mes faktit dhe fiksonit. Sa i ka shërbyer dhe sa i ka ndihmuar krijimtarisë suaj letrare dokumentariteti?

Do të thosha se, në këtë prizëm, këto libra janë të ndryshëm nga njëri-tjetri. "Vjeshta e ankthit" nuk është fikson, ose përmban disa fragmente fiksoni që janë qartazi dhe qëllimshëm të dallueshme si të tilla, kështu që, në tërësi, nuk është fikson. Po as është bazuar në dokumente. Bazohet vetëm në kujtesën time. Ndërsa "Loja, shembja e qiellit" është fikson. Vërtet në dy kapituj i referohet një ngjarjeje historike, siç është futja e armëve nga Sigurimi në kuvendin françeskan të Shkodrës, për çka jam bazuar në kujtimet e pater Zef Pllumit. Por kjo ngjarje historike, ndonëse e ruajtur në thelbin e saj, është plotësuar me detaje të trilluara dhe është e përfshirë në një kontekst ndodhish të trilluara, nëpërmjet një bashkëpunimi të ndërsjellë midis përmasës historike dhe fiksonit. Së fundi, "Liri Belishova dhe koha e saj", përveçse në disa kujtime, është bazuar gjerësisht në dokumente arkivore, por nuk është veprë letrare, është një refleksion mbi politikën, mbi totalitarizmin, me një përpjekje

argumentuese të konkluzioneve analitike.

Te vepra "Loja, shembja e qiellit", koncepti i Zotit jashtë burgut është i ndaluar, kurse përbrenda burgut është kushimisht i lejuar pasi aty të pranishëm janë shumë nga klerikët religjiozë. A i bie kjo se liria brenda burgut ishte më e madhe se jashtë tij në atë kohë?

Edhe jashtë burgut kishte klerikë, ose më mirë ish-klerikë, e jo vetëm në burg. Ndërkaq, në disa aspekte, kryesisht për sa iu takon bisedave midis të burgosurve, kishte më shumë liri shprehjeje në burgun politik sesa jashtë burgut. Me sa duket ngaqë, në njëfarë kuptimi, konsideroheshim të vdekur.

Te libri juaj "Vjeshta e ankthit" shprehni admirimin e madh që keni për Ismail Kadarenë. A keni kontakte sot me të dhe a kishte hatërmbetje nga ana e tij për shkak të akuzave që ia bënte babai juaj dhe aktorët e tjerë të sistemit?

Po, vazhdoj të kem kontakte me Kadarenë. Dhe Kadareja, natyrisht, nuk më mbajti mëri aspak për gjëra që thoshin dhe bënin të tjerë njerëz kundër tij, qoftë dhe kur njëri prej këtyre të tjerëve ishte im atë. Fajësimi i bijve për shkak të prindërve ka qenë kriter i atij

sistemi, po Kadareja, në shpirt dhe në krijimtarin, ka qenë kundër atij sistemi.

Në veprën "Loja, shembja e qiellit", një pjesë të rrëfimit e mbështetni te historia e atë Zef Pllumit. E njihnit Pllumin edhe para rënies së sistemit dhe a u takuat ndonjëherë pas rënies së sistemit?

Jo, s'e kam njohur. Mbas rënies së diktaturës, jo shumë kohë pasi dola nga burgu, jam përpjekur ta takoj. Kishim një mik të përbashkët, një bashkëvuajtës, dhe unë shkova një pasdite me mikun në kishën ku shërbente pater Zefi, që ishte në Tiranë. Po nuk e gjetëm aty, ishte në një udhëtim. Asokohe s'kisha dijeni për ato që ka shkruar pater Zefi për jetën e tij, por kisha një kureshtje intelektuale, ose ndoshta më të thellë, që të njihesha me një prift katolik.

Petro Marko në librin autobiografik "Intervistë me vetveten", ndër shumë personazhe që trajton, e pranishme është edhe figura e Mehmet Shehut. Jeni takuar ndonjëherë me Petron? Nëse po, si ishte si person?

Librin s'e kam lexuar, po me Petro Markon jam njohur. Më ka lënë përshtypjen se ishte njeri i mirë, njeri me dramë dhe njeri stoik.

Kishte disidencë letrare në Shqipëri gjatë komunizmit?

Po. As që mund të vihet në dyshim. Një diktaturë mund ta zhdukë disidencën letrare vetëm duke ndaluar çdo lloj letërsie, sikurse në Kamboxhën e Pol Potit apo në Afganistanin e talibanëve.

Krijimtaria juaj letrare lidhet me sistemin autoritar që ishte i pranishëm në Shqipëri. Sikur të ekzistojë në një vend e në një kohë tjetër, si mendoni që do të dukej vepra juaj? Nuk e di, sepse do të isha njeri tjetër, nuk do të isha ky që jam.

Përveç intervistave jo të pakta, keni shkruar edhe dy libra autobiografikë për babanë tuaj. Pra, e keni shkruar librin "Vjeshta e ankthit" dhe "Rrëfim nga një varr i zbrazët". Nëse babai juaj do t'i lexonte këto libra, cili mendoni se do të ishte gjykim i tij për to e për ju në veçanti?

Atë do të dëshiroja ta dija edhe unë.

Cila ishte Kosova në kujtimet e babait tuaj? Ishte temë ndonjëherë? Aty nga viti 1980 shikuam së bashku filmin "Kur pranvera vonohet" të regjisorit Ekrem Kryeziu, bazuar në kujtimet e Fadil Hoxhës. Tim eti i pëlqeu filmi. E pyeta nëse fakti që bazohej në kujtimet e Fadil Hoxhës mund ta pengonte shfaqjen e filmit në kinematë e Shqipërisë dhe më tha se nuk përbënte kurrfarë problemi, duke shtuar se Fadil Hoxha gjithmonë ka punuar për shqiptarët. Dhe, nuk më kujtohet, a në këtë rast apo më vonë, më tha se Kosova herët a vonë do të bashkohet me Shqipërinë dhe s'ka rrugë tjetër. Ndërsa në vitin '81 i ka pasur në qendër të vëmendjes protestat e Kosovës dhe i konsideronte të drejta në mënyrë absolute.

Po kontaktet tuaja me Kosovën, cilat ishin dhe janë? Sa e njihni letërsinë e Kosovës?

Në kohën e autoizolimit të Shqipërisë këto kontakte kanë qenë shumë të kufizuara: kam takuar disa nga figurat e fushës së letrave: Ali Aliun, Rexhep Ismailin, Ekrem Kryeziun, dhe herë pas here lexoja libra të botuar në Kosovë, kur më binin në dorë, gjë që nuk ndodhte shpesh. Nga botimet e atëhershme kosovare konstatoja se të ju kishte shumë liri krijimtarie dhe botimesh letrare sesa të ne. Me hapjen e Shqipërisë, kuptohet, dhe aq më tepër mbas çlirimit të Kosovës, kontaktet i kam pasur ku e ku më të dendura. Me botën letrare të Kosovës kam pasur lidhje të vazhdueshme bashkëpunimi, madje gjatë njëfarë kohe e kam pasur në Prishtinë botuesin e librave të mi. Dhe për krijimtarinë letrare të Kosovës mund të them se e njoh pak a shumë po aq sa atë të Shqipërisë.

Po zhvillimin e letërsisë në Shqipëri që nga rënia e sistemit komunist e tutje, si e shihni?

Dy gjëra do të përmendja në veçanti: larminë si dhe konvergimin përherë e më të spikatur me



zhvillimet letrare të botës së madhe. Për këtë të dytën, do të thosha se, në fillimet e hapjes, kishte një prirje të theksuar eksperimentalizmi letrar që në botën e madhe është lënë pas prej dekadash. Por tashmë letërsia në Shqipëri po e kapërcen këtë gjendje, çka është tregues pjekurie.

Me gjithë këtë korpus veprash, a ka arritur letërsia jonë shqipe të krijojë tashmë një identitet të vetin?

E ka krijuar prej kohësh, qysh me konsolidimin e shqipes, në fundshekullin XIX, si gjuhë me të cilën bëhet letërsi.

Letërsisë shqipe i mungon Çmimi Nobel. A parashikoni që në një të ardhme të afërt ta gëzojë edhe letërsia jonë këtë çmim dhe cili mendoni se është problemi që nuk e fituam deri sot?

Do të thosha se Çmimit Nobel i mungon letërsia shqipe. Ndërkohë, letërsia shqipe, me autorin e saj më të shquar, Ismail Kadarenë, ka marrë çmime letrare ndërkombëtare që më duken më të rëndësishme se Nobeli. Për shembull Man Booker Prize, qysh në edicionin e parë, ose Çmimi "Princi Asturias". Dhe mendoj se janë më të rëndësishme duke pasur parasysh kandidatët e tjerë dhe fituesit e edicioneve të tjera. Ndërkaq, nuk e di cili mund të jetë problemi që nuk ka një fitues shqiptar të Çmimit Nobel për letërsi ngaqë, duke pasur parasysh fituesit e këtij çmimi së paku në njëzet vjetët e fundit, nuk e kuptoj çfarë kriteresh ndiqen.

Në Shqipëri çdo fundvit ndahen çmime e thaujë asnjëherë ato nuk i fiton ndonjë autor nga Kosova. Për këtë arsye vitin e kaluar pati reaguar edhe studiuesi Rexhep Qosja, duke thënë se "me emërtimin letërsi shqipe nuk mund të quhet vetëm letërsia e

krijuar në Shqipëri, por e gjithë letërsia shqipe e krijuar prej atyre që shkruajnë shqip, pavarësisht ku jetojnë". Bazuar në këtë, a mendoni që po e distanco Shqipëria letërsinë shqipe që bëhet në Kosovë dhe a po kontribuon në qëllimin e disave për krijimin e letërsisë kosovare?

Letërsia shqipe është një pavarësisht se ku krijohet. Kjo ka qenë gjithmonë teza e Kosovës letrare, ndërsa në Shqipëri, në kohën e komunizmit, kundërshtohet, çka shpjegohet me faktin se këto dy treva të letërsisë shqipe i ndante muri i zhdanovizmit të Tiranës. Po sigurisht që teza "një gjuhë, një letërsi" është e drejtë, aq më tepër në rastin shqiptar, përderisa themeli i identitetit tonë kombëtar, ose më mirë baza objektive e tij, është pikërisht gjuha. Po kështu, identitetin e letërsisë shqipe e përcakton gjuha. Ndërsa çmimeve letrare që ndahen s'duhet t'u jepet kaq rëndësi në këtë mes.

Keni punuar kohë të gjatë edhe si skenarist. Si e shihni raportin e letërsisë me filmin? Paraqitja e zhvillimi i filmit, a e kanë zbehur leximin e librit?

Rënia e interesit për leximin nuk vjen nga zhvillimi i kinematografisë, por nga komercializimi i kulturës, i shndërrimit të saj në spektakël zbatimjeje.

Përveç shkrimtar, jeni edhe përkthyes. Sot në vendet tona shqiptare përkthehet më shumë se kurrë. Si i vlerësoni për nga cilësia përkthimet e kohës sonë?

Sigurisht gjejmë përkthime shumë të mira edhe sot, por janë gjithsesi të rralla. Pjesa më e madhe janë shumë të dobëta, edhe kjo për shkak të komercializimit të kulturës, konkretisht për shkak të përparësive të një pjese të madhe të botuesve, të atyre që rendin

mbas fitimit dhe e harrojnë cilësinë.

Ju ka rënë të lexoni shumë autorë të huaj, por edhe vendorë. Ku qëndron arti ynë shqiptar në relacion me atë ballkanik, evropian dhe botëror?

Në një pozicion dinjitoz.

Jetoni në Barcelonë prej kohësh dhe besoj ju ka rënë të shihni mjaftueshëm se sa e si lexohet atje. Cila është kultura e leximit te ne nëse e krahasojmë me kulturën e leximit në Evropë?

Kam përshtypjen se janë të ngjashme. Dhe, po të nisemi nga shifrat, nëse këtu shitja e një libri arrin në 3 000 ekzemplarë, libri konsiderohet i përligjur nga pikëpamja e tregtimit. Përpjesëtimisht me popullsinë, i bie që kuota në Shqipëri të jetë rreth 200 ekzemplarë dhe në Kosovë 150. Kjo tregon se kemi një bërthamë solide lexuesish. E kam fjalën për letërsinë serioze. Ndërsa për ata libra synimi i të cilëve nuk është cilësia letrare, por shitja, nuk e kam të qartë.

Jeni autor i shumë librave, por a mund ta veçoni njërin me të cilën do të donit të mbaheshit mend?

Do të doja të ishte ndonjë nga librat që ende s'i kam shkruar.

Secili autor ndikohet nga dikush. Kjo mund të ndodhë qëllimshëm, por edhe në mënyrë të tërthortë e të pavetëdijshme. Nga intervistat tuaja e vërejmë një pëlqim që keni për Kafkën, Danilo Kishin e autorë të tjerë. Mund të jeni ndikuar me ose pa qëllim prej tyre?

Siç thoni ju, çdo autor ndikohet nga dikush. Ose, më mirë të themi, nga disa "dikushër". Kjo sigurisht ndodh në mënyrë të vetvetishme, të paqëllimshme. I qëllimshëm nuk është ndikimi, po imitimi.

Nietzsche thotë se e kemi artin që të

mos vdesim nga e vërteta. Ç'është arti në tërësi e letërsia në veçanti për ju? Ikje nga realiteti i mundimshëm?

Më mirë të themi, është shprehje refuzimi i të qenit heteronom. Por ky refuzim nuk është një ikje nga bota reale në një botë imagjinare: tekefundit, jemi dhe kemi qenë gjithmonë të ikur nga bota reale, jemi të huaj në këtë botë. Pikërisht kjo tëhuajtje, që ka si bashkudhëtare ngulmimin që të jemi në botën ku jetojmë, ndoshta përbën arsyen pse ekziston diçka e tillë si letërsia, sikurse forma të tjera, jo vetëm artistike, të imagjinatës në veprim: për të gjetur një kuptim ose një ngushëllim të genies sonë në këtë botë, e cila nuk është bërë për njeriun dhe njeriu nuk është bërë për t'u ndier si në shtëpinë e tij në këtë botë.


Për dallim nga koha e Nietzches që nuk është e largët, studimet sot vlerësojnë se më shumë lexohet proza dokumentare dhe biografite e ndryshme sesa veprat fikzionale të mbushura me figura mitologjike e histori magjike. Si e shihni këtë fenomen?

E shoh të lidhur me fenomenin e ndjekjes masive të programeve televizive me *reality show*. Mendoj se ky fenomen përbën formën vulgare të leximit të asaj lloj letërsie jofiksion për të cilën e keni fjalën, sikurse kjo e fundit përbën formën kulte të fenomenit që përmenda.

Dhe për fund duam një këshillë nga ju për shkrimtarët e rinj, të cilët sot nuk janë pak...

Të jepja këshilla në përgjithësi, më duket paternalizëm ndaj të rinjve. Do ta parapëlqejja bisedën individuale, si koleg me kolegun, në të cilën mund të jepja ndonjë mendim duke u nisur nga ndonjë shkrim i tjetrit në mënyrë të natyrshme dhe në përshtatje me rastin individual.

Përtej inteligjencës artificiale: Biokompjuterët e ndërtuar me neurone njerëzore



Një studim i ri flet mbi mundësinë e prodhimit të pajisjeve me pajisje biologjike. Pra një Inteligjencë artificiale, por me një përmasë njerëzore, që do të bazohet tek procesorët e ndërtuar me qeliza nervore njerëzore të vërteta, të ashtuquajturit biokompjuterë.

Kjo qasje e re “hibride” ndaj teknologjisë së informacionit, po diskutohet aktualisht nga një ekip shkencëtarësh nga Universiteti Xhon Hopkins dhe institute të tjera kërkimore. Në një studim të sapo-botuar në revistën “Frontiers in Science”, ata përshkruajnë mënyrën se si mund të krijohet një pajisje e bazuar tek një harduer biologjik.

Pra neuronet e kultivuara të njeriut të quajtur organoidë të trurit, që mund të programohen për të zgjidhur probleme, dhe në përgjithësi të kryejnë detyra të caktuara llogaritëse. “Ne e kemi quajtur këtë fushë të re ndërdisiplinore Inteligjenca Organoide, OI. Për ta zbatuar këtëkoncept po punon një komunitet shkencëtarësh të shkëlqyer. Ne besojmë se ajo do të nisë një epokë të re të bioinformatikës efikase, të shpejtë dhe të

fuqishme”- thotë Tomas Hartung nga Universiteti Xhon Hopkins.

Për të shmangur dyshimet, duhet të saktësohet se për momentin ideja “është thjesht teorike” siç e thekson për agjencinë italiane të lajmeve, ANSA, Kiara Maljaro, studiuese e Qendrës E. Piaggio në Universiteti i Pizës. Ajo shton se “imagjinon në perspektivë shfaqjen e një brezi të ri kompjuterësh të frymëzuar nga trupi i njeriut”.

Po çfarë janë organoidet cerebrale? Krijimi i organeve njerëzore në epruvetë (zemra, veshkat, pankreasi etj) është një teknikë që përdoret tashmë prej disa vitesh, sidomos për testimin e barnave ose për studimin e ndryshimeve mikro-strukturore tek indet e sëmura.

Ato mund të prodhohen në mënyra të ndryshme. Për shembull duke filluar nga qelizat e gjalla, si në rastin e projektit NAP apo me materiale artificiale. Në vitin 2016 një ekip shkencëtarësh nga Universiteti Vanderbilt krijuan në laborator një mikromëlçë që riprodhon kushtet e një mëlçie të vërtetë dhe që ofron informacione me vlerë

për të kuptuar sistemet e mbijetesës së qelizave të mëlçisë si dhe mundëson studimin e efekteve të barnave në inde.

Në vitin 2022 (por nuk ishte hera e parë) një grup studiuesish nga Universiteti i Torontos dhe Montrealit zhvilluan një sistem që kombinon një sistem polimeresh dhe kultura qelizore për të riprodhuar barkushen e majtë të zemrës. Ajo po përdoret për të studiuar funksionin qelizor dhe të indeve, pa pasur nevojë për kirurgji invazive apo teste te kafshët.

Po në këtë mënyrë po arrihet tek truri. Në vitin 2019, një studim i botuar në revistën “Stem Cell” përshkroi krijimin e një mini-truri, nga një grup studiuesish nga Universiteti i Kalifornisë, San Diego, i aftë të shfaqë një aktivitet cerebral shumë të ngjashëm me atë të trurit të fëmijëve të lindur para kohe.

Ndërkohë në vitin 2021, një tjetër mini-tru në një epruvetë, i krijuar nga startup-i teknologjik Cortical Labs, arriti madje të “luajë” videolajm Pong. Teknikisht, organoidet cerebrale nuk janë saktësisht

mini-tru të tipit të sapo-përshkruar, por ato ndajnë shumë aspekte dhe karakteristika, veçanërisht në aspektin e strukturës dhe “funktionalitetit”, duke përfshirë performancën e aktiviteteve njohëse (elementare) si mësimi dhe memorizimi.

Atëherë, pse të mos përpiqemi të përdorim një imitim të trurit njerëzor për të ndërtuar një kompjuter? Për këtë ka disa arsye, dhe të gjitha shumë të vlefshme: “Kompjuterët tradicionalë, të bazuar tek silikoni, janë sigurisht shumë të mirë në manipulimin e numrave –shpjegon Hartung – por truri është shumë më i mirë në mësimin e informacionit.

Për shembull, AlphaGo, inteligjenca artificiale e Google që mposhti kampionin botëror Go në vitin 2016, u trajnuar duke studiuar rreth 160.000 lojëra. Një qenie njerëzore duhet të luajë 5 orë në ditë për më shumë se 175 vjet për të arritur në të njëjtin numër. Ndërkohë përveçse është më i aftë për të mësuar, truri i njeriut është gjithashtu shumë më efikas se sa një kompjuter. Energjia e nevojshme për të

trajnuar AlphaGo ishte më e lartë se ajo e nevojshme për të “ushqyer” një qenie njerëzore të rritur për 10 vjet. Dhe nuk mbaron këtu, pasi edhe për nga kapaciteti nuk ka krahasim. “Truri ka një kapacitet të jashtëzakonshëm, rreth 2500 terabajt. Ne po arrijmë kufijtë fizikë të silikonit, pasi nuk mund të vendosim më shumë transistorë në çipa.

Ndërkohë truri është “lidhur” në një mënyrë krejtësisht të ndryshme: ai ka rreth 100 miliardë neurone, të lidhur në një numër të madh pikash lidhjeje. Është një ndryshim i madh fuqie, krahasuar me teknologjinë aktuale. Por si mund të realizohet kjo në praktikë?

Nga ky këndvështrim jemi ende shumë larg qëllimit. “Së pari duhet të jemi në gjendje të zmadhojmë organoidet cerebrale. Për momentin ato janë shumë të vogla, dhe secila prej tyre përmban rreth 50 mijë qeliza. Ne duhet të jemi në gjendje të arrijmë të paktën 10 milionë qeliza”- thekson Hartung, që shton se për momentin është e pamundur të vendoset një afat kohor realist.

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Invert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Donjeta Sadiku nuk merr pjesë në Kampionatin Botëror për shkak të kushtëzimit të simboleve shtetërore

Për herë të tretë Donjeta Sadikut i mohohet pjesëmarrja në Kampionatet Botërore në Indi dhe njëherësh mundësia për të fituar një tjetër medalje botërore. India kushtëzoi pjesëmarrjen e Sadikut pa simbole shtetërore, por një gjë e tillë është refuzuar nga Federata e Boksit e Kosovës në koordinim me Komitetin Olimpik të Kosovës dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 14 MARS - Donjeta Sadiku përfundimisht ka mbetur jashtë Kampionatit Botëror të Boksit i cili filloi të martën në New Delhi të Indisë. Kjo nuk është hera e parë që sportistët e Kosovës hasin në probleme për pjesëmarrjen në Kampionate Botërore nga shtetet të cilat nuk e njohin shtetin e Kosovës. Federata e Boksit e Kosovës qysh nga muaji janar ka dorëzuar

dokumentacionin e kompletuar për pjesëmarrje në Kampionatin Botëror në Indi, por kjo nuk solli rezultat. Federata e Boksit e Kosovës ka reaguar lidhur me mospjesëmarrjen e boksieres Donjeta Sadiku në Kampionatin Botëror. FBOXK-ja ka dhënë detaje për mospjesëmarrjen në Botëror. Sipas Federatës së Boksit, India ka lejuar pajisjen me viza, por me dy kërkesa: Flamuri i Kosovës dhe himni shtetëror nuk do të përdoren në ndonjërin nga ceremonitë gjatë



kampionatit botëror dhe pjesëmarrësit e Kosovës nuk do të lejohen ta bartin flamurin e tyre ose edhe në veshjet e tyre në formë të printuar. Pas diskriminimit të bërë, Federata e Boksit, në koordinim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komitetin Olimpik

të Kosovës, vendosen të mos udhëtojnë fare drejt New Delhit të Indisë. "Andaj, bazuar në kushtet e vëna dhe diskriminimin e bërë nga shteti i Indisë, FBoxk, në koordinim me MKRS-në dhe KOK-un, kanë vendosur që ekipi ynë të mos udhëtojë fare drejt New Delhit të Indisë. Për ne si

federatë, por edhe për boksieren, e cila ishte favorite për të fituar sërish medalje, është zhgënjim i madh, sidomos me Federatën Ndërkombëtare të Boksit (IBA), e cila lejoi që për herë të tretë i njëjti vend ta diskriminojë boksieren tonë, duke ia mohuar pjesëmarrjen me të drejta të barabarta si sportistët e tjerë", thuhet në njoftimin e Federatës së Boksit.

Kjo e fundit konsideron se sërish politika është bërë pengesë e sportit. FBOXK-ja e ka falënderuar zëvendësministren Daulina Osmani për angazhimin dhe përpjekjen e saj për pajisjen me viza për ekipin e Kosovës. Kjo është hera e tretë që Donjeta Sadiku i mohohet pjesëmarrja në Kampionatet Botërore në Indi, njëherësh mundësia për të fituar një tjetër medalje botërore.

Reali dhe Napoli presin konfirmimin në çerekfinale

"Epoka e re"

MADRID, 14 MARS - Real Madridi dhe Napoli presin që sonte (e mërkurë) ta konfirmojnë kalimin në çerekfinale të Ligës së Kampionëve, pasi në ndeshjet e para ndaj Liverpoolit dhe Eintracht Frankfurtit kanë fituar si mysafirë. Reali i Carlo Ancelottit ishte duke humbur ndeshjen e parë në "Anfield" me rezultat 2-0, por arriti të rikthehet fuqishëm

duke shënuar fitore me përmbyseje 5-2. Vetëm një mrekulli do ta eliminonte skuadrën spanjolle nga Liga e Kampionëve në këtë fazë. Fituesi në fuqi i "Topit të Artë", Karim Benzema, mungoi ndaj Espanyolit në fundjavë, por do ta udhëheqë Realin në ndeshjen ndaj Liverpoolit dhe kjo është një gjë pozitive për trajnerin Ancelotti, duke ditur cilësitë që ka sulmuesi francez. Mungesa e vetme pritet të jetë David Alaba.

Në anën tjetër, te Liverpooli mungojnë Luis Diaz, Thiago Alcantara, Calvin Ramsay dhe Joe Gomez. Në anën tjetër, Napoli që po shkon sigurt drejt titullit kampion në Serinë A, është afër kalimit në raundin tjetër për faktin se e mposhti Frankfurtin me rezultat 2-0 në Gjermani.

TË MËRKURËN TAKOHEN:

21:00 Real Madrid - Liverpool (5-2)
21:00 Napoli - Eintracht Frankfurt (2-0)



Presidenti i Federatës zvicerane: Ndeshjet me Kosovën do të jenë duele mes miqsh



CYRËH, 14 MARS - Presidenti i Federatës zvicerane të Futbollit, Dominique Blanc, ka folur për përballjet që i presin "helvetikët" në kualifikimet e Euro 2024, përfshirë këtu edhe ato me Kosovën. Dy kombëtalet do të përballen në mes vete dy herë gjatë këtij viti në kuadër të eliminatorëve për Evropianin e ardhshëm, ndërsa për të dyja vendet këto konsiderohen si duele speciale, duke e pasur

parasysh se disa lojtarë të "dardanëve" janë lindur e rritur në Zvicër dhe, në anën tjetër, disa lojtarë nga Kosova luajnë për Zvicrën. E për këto ballafaqime ka folur edhe numri 1 i futbollit zviceran. "Për mua ndeshjet kundër Kosovës janë dy duele mes miqsh. E kemi një komunitet të gjerë dhe të madh kosovar në vendin tonë. Është mjaft mirë i integruar dhe i kemi disa lojtarë në kombëtare që janë

me prejardhje kosovare. Kemi raporte të mira me Kosovën në të gjitha nivelet. Për këtë arsye, dy ndeshjet do të jenë edhe një lloj feste, përkundër rëndësisë së tyre sportive", u shpreh kreu i futbollit zviceran për mediumin e atjeshëm "Blick".

Granit Xhaka dhe Xherdan Shaqiri do të zbarkojnë në Kosovë sivjet për një ndeshje të veçantë dhe të paharrueshme për ta.

Harris, MVP i javës në Superligë

SUHAREKË, 14 MARS - Java e 25-të e Prince Caffè Superligës dhuroi disa ndeshje mjaft interesante. Basketbollisti me indeksin më të lartë ishte qendra e Golden Eagle Yllit, 39. Harris ndeshjen ndaj Ponte Prizrenit e mbylli me 21

pikë e 18 kërcime, ndërsa shtoi edhe një asistim, një top të vjedhur dhe gjashtë bllokada. Ai u ndihmua nga qendra Gëzim Morina me 15 pikë, 12 kërcime e katër asistime. Sigal Prishtina fitoi derbin ndaj Trepçës. Më i miri

në parket për skuadrën prishtinase ishte Derrick Wilson me 14 pikë, pesë kërcime e gjashtë kërcime. Peja shënoi fitore ndaj Vëllaznimit. Shtatë basketbollistë të verdhezinjtë shënuan pikë dyshifrore,

kurse më i miri ishte Larry Thomas me 21 pikë, katër kërcime dhe shtatë asistime. Rahoveci regjistroi fitoren e katërt këtë edicion, ndërsa ndaj Bashkimit u dallua Jack Pagenkopf me 20 pikë, gjashtë kërcime dhe gjashtë asistime.



Berisha: Jam apo nuk jam te Kosova, me shpirt uroj të kualifikohemi

PRISHTINË, 14 SHKURT - Një nga futbollistët që po kalon formë jashtëzakonisht të mirë në kampionatin rus tek Ahkmat Grozny, Bernard Berisha, duket se është "harruar" edhe nga përzgjedhësi i ri Alian Giresse. Që nga episodi kur

kishte një mosmarrëveshje me trajnerin e atëhershëm Bernard Challandes, Berisha nuk është ftuar më në Përfaqësuese. Pavarësisht kësaj, ai është i gatshëm çdoherë ta ndihmojë Kosovën, madje edhe nëse

fare nuk ftohet ai me shpirt uron që Kosova të kualifikohet në Evropian. "Unë jam duke kaluar në një formë shumë të mirë dhe jam i lumtur. Sa i përket nëse kam pasur ftesë, për momentin nuk kam pasur asnjë kontakt

nga përzgjedhësi, por pak ka rëndësi kjo. Unë me zemër ju uroj shumë suksese në ndeshjet e radhës sepse është koha që ta dërgojmë Kosovën përpara", ka thënë Bernard Berisha për "Demokracia.com".



Ramadani: Synoj të bëhem kampion i Evropës dhe botës

PRISHTINË, 14 MARS - Atleti kosovar Muhamet Ramadani fitoi medaljen e artë në Kupën Evropiane të hedhjeve U-23 që u mbajt në Leiria të Portugalisë. Ramadani hodhi gjylen në largësi 19.28 metra, distanca kjo më e largët nga të gjithë rivalët e tij në këtë garë. Pas zbakimit në Prishtinë, Ramadani për "KosovaPress" ka thënë se kishte punuar jashtëzakonisht shumë për ta arritur këtë sukses dhe ia doli përballë shteteve shumë të fuqishme. "Jemi përgatitur për këtë medalje, po ashtu edhe për këtë rezultat. Nuk ka qenë rezultat befasues për ne, por ka qenë rezultat i pritshëm ku kemi punuar prej muajit tetor për këtë garë ku edhe na u shpërblye munda me medaljen e artë dhe me një rekord personal dhe rekord shtetëror... Konkurrenca ka qenë tepër e fortë marrë parasysh që kanë qenë të gjitha shtetet e Evropës, kanë qenë 40 shtete. Ndër rivalët ishin Italia, Gjermania, Spanja. Ka pasur edhe rivalë të tjerë, por me rezultat më të dobët", ka thënë Ramadani. Ai shtoi se në të ardhmen synon ta rrëmbejë medaljen e artë edhe në Kampionatin Evropian që mbahet në verën e këtij viti. "Po, është një motiv shtesë pasi që është një medalje për mua, për Kosovën. Presim tani të punojmë për garën tjetër. Është Kampionati Evropian



në korrik të këtij viti. Edhe atje presim ta fitojmë medaljen e artë", theksoi ai.

I lumtur me suksesin e tij u shpreh edhe trajneri dhe babai i tij, Shaban Ramadani. Ai theksoi se këtë vit synimi është që të arrihet norma olimpikë. "Të jesh i pari në Evropë është një diçka shumë e vlefshme. Kur ishte fjala te konkurrenca, ajo ka qenë e jashtëzakonshme pasi kanë marrë pjesë 40 shtete të Evropës dhe aty vetë pjesëmarrja e tyre e tregon konkurrencën e tyre. Qëllimi ynë është t'i ofrohem këtij vit sa më shumë normës olimpikë e cila duhet të punohet mjaft shumë për ta arritur mirëpo, dalëngadalë, shkallë pas shkalle, besoj se do t'i ofrohem edhe normës olimpikë këtë vit", ka theksuar ai.

Ndërsa kryetari i Federatës Atletike të Kosovës, Halil Sylejmani, tha se

rezultatet dhe sukseset e Ramadanit janë stimul për atletët e rinj për të arritur suksese kulminante. "Federata Atletike e Kosovës tani është me kampion evropian dhe unë e përgëzoj dhe e uroj përzemësisht në emër timin dhe të Federatës Atletike të Kosovës këtë djallë të ri i cili është duke shkëlqyer dhe me siguri dalëngadalë do të arrijmë edhe kampion botëror dhe olimpik. Puna e tij dhe e trajnerit të tij Shabani është për t'u lavdëruar dhe për t'u përkrahur nga të gjithë ne... Rezultatet e Muhametit janë edhe për atletët e ardhshëm si stimul apo si nxitës për të arritur rezultate të mira", ka shtuar Sylejmani. Sylejmani, gjithashtu, kërkoi edhe mbështetje më të madhe nga Ministria e Sportit dhe Komiteti Olimpik për sportin e atletikës në Kosovë.

Final 4 në Vlorë, gati për spektakël

VLORE, 14 MARS - Në qytetin e bukur dhe historik të shqiptarëve është koha për spektaklin e basketbollit të femrave. Katër skuadrat më të mira të Shqipërisë dhe Kosovës do të garojnë për trofeun e çmuar më 15 e 16 mars. Final 4 i Ligës Unike të Femrave do të organizohet në qytetin e Vlorës nga Flamurtari. Nga Shqipëria do të garojë edhe Partizani, kurse nga Kosova janë Bashkimi dhe Prishtina. Klubi vlonjat është kampion i Shqipërisë dhe fitues i Superkupës Mbarëkombëtare, ndërsa Prishtina është kampione e parë e kësaj gare, kurse Bashkimi së fundi fitoi Kupën e Kosovës. Kjo bën që të pritët një supergarë në Vlorë. Në gjysmëfinale do të përballen



Flamurtari me Prishtinën, që u renditën në vendin 2 dhe 3, derisa Bashkimi, që ishte i pari, do të sfidohet nga Partizani, që u rendit i katërti. Ndeshja për vendin e tretë dhe finalja e madhe do të zhvillohet të enjten.

TË MËRKURËN TAKOHEN:
16:00 Flamurtari - Prishtina
19:00 Bashkimi - Partizani

TË ENJTEN TAKOHEN:
16:00 Ndeshja për vendin e tretë
19:00 Ndeshja Finale

Verstappen: Për dy vjet kam arritur më shumë fitore se Ferrari

Piloti holandez Max Verstappen, kampion bote në Formula 1 në dy sezonet e fundit, ka përdorur tone të ashpra ndaj Ferrarit. Ai ka thumbuar "kokëkuqen",

duke e konsideruar një makinë jokompetitive, duke parë rezultatet që kjo makinë ka arritur vitet e fundit. Në dy sezonet e fundit, që është shpallur

kampion bote, Verstappen ka arritur 26 fitore në Formula 1, ndërsa Ferrari, në 10 vjetet e fundit, vetëm 23. "Në dy vjet unë kam arritur më shumë fitore sesa

Ferrari. Kjo tregon se ata janë shumë larg nesh", ka thënë holandezi i Red Bullit. Edhe këtë sezon Red Bulli e ka nisur mbarë sezonin, duke u renditur në dy

vendet e para me Verstappenin e Perezin. Kjo lë të mendosh se makina austriake do të ketë një vit të lehtë, pasi rivalët janë ende shumë larg.

SHKURT

Enisa Kamerolli vazhdon sukseset në ShBA

UT Tyler fiton Turneun Rajonal të NCAA South Central. Ekipi i basketbollit UT Tyler, ku pjesë është edhe basketbollistja e Kosovës, Enisa Kamerolli, vazhdon me suksese. UT Tyler jo vetëm që është kualifikuar për turneun e parë NCAA DII, por pasi ka fituar dy ndeshjet e para, të hënën në mbrëmje ka mundur Lubbock Christian 67:64 në kohën shtesë për të depërtuar në Elite Tight. Tani UT Tyler do të përgatitet për raundin çerekfinal që zhvillohet në Misuri. Enisa Kamerolli ka qenë pjesë e grupmoshave të Kosovës, ndërsa ka luajtur edhe me Kosovën A në debutimin më 2021 në Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla në Qipro.

Rrahmani në formacionin e javës në Serinë A

Kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës, Amir Rrahmani, vazhdon shkëlqimin me Napolin, duke marshuar me hapa të sigurt drejt titullit në Serinë A. Shenja në këtë sezon mbresëlënëse po arrijn të lë edhe mbrojtësi nga Kosova, i cili në 23 ndeshje sa ka zhvilluar gjithsej, ka shënuar dy gola dhe ka dhuruar një asistim. Në fitoren e fundit ndaj Atalantës (2-0), Rrahmani shënoi gol me kokë. Paraqitja e mirë në atë përballje ka bërë që futbollisti "dardan" të jetë pjesë në formacionin e javës në Serinë A.

Presidenti i La Ligës: Vetëm Reali mund ta blejë Mbappen

Presidenti i La Ligës, Javier Tebas, ka shprehur dëshirën për ta parë sulmuesin e Paris Saint-Germain, Kylian Mbappe, në kampionatin spanjoll. Sipas Tebas, i vetmi klub në ligë që mund të përballojë të nënshkruajë me një sulmues është Real Madridi. "Në La Liga, Real Madridi është i vetmi klub që mund ta blejë Mbappen. Do të doja ta shihja në La Liga", ka thënë Tebas. Verën e kaluar 24-vjeçari Mbappe mund të kishte kaluar te klubi madrilen, por në momentin e fundit vendosi ta vazhdojë kontratën me parisienët.

Pioli: Duhet të kishim bërë më mirë, jemi të zhgënjyer

Trajneri AC Milan, Stefano Pioli, është ndarë i zhgënjyer pas barazimit që skuadra kuqezi e arriti në përballje me Salernitanën (1-1) në kuadër të Serisë A. "Ishte një mundësi e shpërdoruar. Duhet të kishim bërë më mirë dhe jemi të zhgënjyer për këtë. Duhet të rritemi nëse dëshirojmë të jemi një skuadër në nivel të lartë. Ekipet e mëdha luajnë çdo ndeshje sikur të ishte decizive", ka thënë Stefano Pioli.

Pas javës së 26, Milani është në vendin e katërt në kuotën e 48 pikëve, 2 më pak se Interi i vendit të dytë.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

FTESË PËR OFERTË FURNIZIM

Konform udhëzuesit të brendshëm për prokurim Nr. 1/2009, për Autoritetet e Likuidimit

Data: 15.03.2023

I: AUTORITETI KONTRAKTUES: Agjencia Kosovare e Privatizimit, Autoriteti i Likuidimit, ZR Pejë, ZR Prizren, ZR Gjilan.

NENI II: QËLLIMI I KONTRATËS

II.1 Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Furnizim me kuti arkive (gjerësia 10cm), sasia 32500 kuti, doreza medicinale - sasia 150 kuti (me nga 100 copë) dhe maska mbrojtëse nga pluhuri - 100 kuti (me nga 100 copë).

II.2 Lloji i kontratës dhe lokacioni i dorëzimit:

Furnizim me material për Arkiv- kuti arkivi, maska dhe doreza, për ZR Pejë, ZR Prizren, ZR Gjilan. Lokacioni i dorëzimit është në AKP, ZQ Prishtinë - Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, 10.000 Prishtinë.

NENI III: KËRKESAT të cilat duhet të përmbushen nga OPERATORET EKONOMIK

IV.1 AFATI KOHOR PËR KËRKESAT E INFORMACIONEVE SHITESË OSE SQARUESE

IV.2 KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS

Oferta e përgjegjshme me çmim më të ulët

IV.2 Afati kohor për pranimin e tenderëve: më së voni më 31 Mars 2023 koha: 14:00.

IV.3 Takimi për hapjen e tenderëve:

Data: 31 Mars 2023 **Koha:** 14:30:00 **Vendi:** Objektin e AKP-së, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, 10.000 Prishtinë

- Tenderuesit fitues dhe apo/eliminues do të njoftohen përmes emailit
- Ofertat duhet të jenë në zarf të mbyllur dhe të vulosura. Shikoni me kujdes kushtet të cilat duhet të plotësoni.

Kërkesa për dosjen e tenderit: Dosja e tenderit mund të shkarkohet në webfaqen www.pak-ks.org.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

POZIV ZA PODNOŠENJE PONUDA SNABDEVANJE

U skladu sa unutrašnjim uputstvom za nabavku br. 1/2009, za Likvidacione organe

Datum: 15.03.2023. godine

I: UGOVORNO TELO: Kosovska agjencia za privatizaciju, Likvidacioni organ, RK Peć, RK Prizren, RK Gnjilane.

ČLAN II: SVRHA UGOVORA

II.1 Naziv ugovora dat od strane ugovornog tela: Snabdevanje arhivskim kutijama (širine 10 cm), količina 32500 kutija, medicinske rukavice - količina 150 kutija (sa po 100 komada) i maske za zaštitu od prašine -100 kutija (sa po 100 komada).

II.2 Vrsta ugovora i mesto isporuke:

Snabdevanje materijalom za arhivu - arhivske kutije, maske i rukavice, za RK Pejë, RK Prizren, RK Gnjilane. Mesto isporuke je u KAP, GS Priština - Ul. "Dritan Hoxha" br. 55, Lakrishtë, 10.000 Priština.

ČLAN III: ZAHTEVE koje treba da ispune PRIVREDNI SUBJEKTI

IV.1 ROK ZA ZAHTEVANJE DODATNIH INFORMACIJA ILI POJAŠNJENJA

IV.2 KRITERIJUMI ZA DODELU UGOVORA

Odgovarajuća ponuda sa najnižom cenom

IV.2 Rok za prijem tendera: najkasnije do 31. marta 2023. godine Vreme: 14:00 časova.

IV.3 Sastanak za otvaranje tendera:

Datum: 31. mart 2023. **Vreme:** 14:30:00 **Mesto:** Objekat KAP-a, Ul. "Dritan Hoxha" br. 55, Lakrishtë, 10.000 Priština

- Pobjednički i/ili eliminisani ponuđači biće obavješteni preko imejla
- Ponude treba da budu u zatvorenoj i zapečaćenoj koverti. Pažljivo pogledajte uslove koje treba da ispunite.

Zahtev za tenderski dosije: Tenderski dosije možete preuzeti sa vebstranice www.pak-ks.org.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Drilon Zyberi shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Bekim Uka shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Rinora Islami nga Mitrovica shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Xheladin Deda" Mitrovicë.

- Hajrulla Sofiu nga Dragashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl.I,II,III,IV të shm Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Edona Rezniqu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Mjekësisë "Hysni Zajmi" Farmaci.

- Gëzim Maroshi nga Damjan kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e sh fillore "Hamez Cena" Damjan kk Gjakovë.

- Besfort Parashumti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e shm Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



Ndërmarrje publike lokale | Rr. Egnatia p.n. - 10 000 Prishtinë | www.kuzhina.net | kuzhinagendrore@gmail.com | tel: + 383 45 709 106

Në bazë të nenit 164 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare 06/L-016, nenit 16.2 dhe 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti III/nr. 31/15 qershor 2008), dhe plotësim ndryshimeve përkatëse me Ligjin nr. 04/L-111 dhe nr. 05/L-009, dhe në pajtim me normat tjera pozitive relevante, Komisioni Komunal i Aksionarëve të N.P.L. KUZHINA QENDRORE SH.A. në Prishtinë, me datën **15.03.2023**, shpall këtë:

KONKURS

Pozitat: Katër (4) anëtarë të Bordit të Drejtorëve të N.P.L. KUZHINA QENDRORE SH.A. në Prishtinë.

I përgjigjen: Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L. KUZHINA QENDRORE SH.A. në Prishtinë.

Mandati: Tri (3) vite.

Kompensimi: Konform nenit 20 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087, dhe plotësim ndryshimeve përkatëse.

1. Të përgjithshme

Kandidati/ja për këtë vend pune duhet të jetë person me integritet, i cili/e cila i plotëson kushtet e kualifikimit dhe kriteret e pavarësisë, posedon përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar, si dhe i plotëson kushtet tjera të kërkuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe aktet tjera pozitive relevante.

2. Kushtet e kualifikimit profesional dhe përshtatshmërisë

Çdo kandidatë për t'u konsideruar në pozitën e Drejtorit të Bordit, duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë - së paku në një nivel të lartë të menaxhmentit në fushat si vijon: në administrim të biznesit; - financa të korporatave; - financa; - menaxhim thesari; - banka; - konsulencë në biznes ose industri; ose - nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë, e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste - të ndërmarrjes; ose për së paku pesë (5) vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar- i kualifikuar i një profesioni tjetër, i cili ndërlihet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së.

3. Papajtueshmëria

Konform ligjit në fuqi, një person nuk ka të drejtë të shërbejë si drejtor në Bordin e Ndërmarrjeve publike, nëse: a) Ka qenë i/e dënuar nga një gjykatë kompetente, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë tjetër në bazë të ankesës; ka kryer vepër penale ose civile, vepër që përfshinë

përgënjeshttrimin, prezantimin e rrejshëm, korrupsionin, vjedhje, pastrimin e parave, përvetësimin, keqpërdorimin apo ndarjen e rrejshme të fondeve; ka qenë i/e përfshirë në mitosje apo rryshfet sipas ligjeve apo rregulloreve në fuqi në Kosovë apo ndonjë vend tjetër, apo sipas traktateve ose konventave ndërkombëtare; b) është vendosur nga një gjykatë ose organ apo organizatë përgjegjëse për zbatimin e kodit etik apo standardeve të sjelljes profesionale, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër në bazë të ankesës (i) se është angazhuar në sjellje jo profesionale, (ii) se ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, (iii) se ka keqpërvetësuar apo ka keqpërdorur paratë apo burimet publike, (iv) se ka keqpërdorur apo keq-përvetësuar informatat (të dhënat) e fituara gjatë shërbimit si zyrtar publik apo shërbyes civil, ose (v) se ka keqpërdorur postin publik ose postin në shërbimin civil për përfitime personale ose për përfitime apo përparësi të një të afërmi ose të njohuri; apo; c) ka bërë përgënjeshtime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim apo betimi tjetër, ose dokumenti të vulosur apo noterizuar; dhe d) është shpallur i falimentuar gjatë dhjetë (10) viteve të kaluara; e) punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrje Publike përkatëse ku kandidati punon.

Të gjithë drejtorët duhet të jenë të pavarur. Një person nuk konsiderohet i pavarur dhe nuk kualifikohet për zgjedhje si drejtor në një NP nëse:

a) aktualisht është zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj, ose ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj brenda pesë (5) viteve të kaluara;

b) aktualisht është punonjës i nivelit të lartë i NP-së përkatëse, ose ka shërbyer si punonjës i nivelit të lartë në NP-në përkatëse brenda tri (3) viteve të kaluara;

c) aktualisht ka, ose gjatë tri viteve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç; si konsumator individual i shërbimeve të NP-së) me NP-në përkatëse ose cilëso nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;

d) është aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i lartë në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili ka marrëdhënie materiale afariste me NP-në përkatëse ose cilëso nga filialet e saj;

e) pranon, ose ka pranuar brenda tri (3) viteve të kaluara, kompensim shtesë nga NP përkatëse ose cilëso nga filialet e saj (përveç; honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar në nenin 20.1 të ligjit primar, ose është anëtar në skemën pensionale të NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj;

f) mban drejtorësi të ndërsjellë ose ka lidhje të konsiderueshme me drejtorët e tjerë të NP-së përkatëse përmes përfshirjes në shoqëri tjera tregtare ose organe;

g) përfaqëson në aksionar i cili posedon dhjetë për qind (10%) të aksioneve votuese në NP-në përkatëse;

h) ka shërbyes në Bordin e Drejtorëve të NP-së përkatëse me shumë se nëntë (9) vite nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj; është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e "Interesit Financiar" në nenin 2 të ligjit primar i cilitdo person që i takon cilëso nga kategoritë më sipër përveç personit të përcaktuar në pikën (b); ose

i) është ose (i) punonjës, zyrtar, drejtor ose aksionari, ose ka një Interes Financiar në, një shoqëri tregtare të pa-listuar dhe që konkurren me Ndërmarrjen, ose (ii) menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy për qind (2%) të të drejtave të votimit) i, ose ka një Interes të konsiderueshëm Financiar në, cilëndo nga shoqëritë tregtare të llastuara që konkurrojnë me Ndërmarrjen; dhe

j) është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;

k) ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktoje që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutine, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij fiduciare ndaj Aksionarëve dhe NP-së.

4. Dokumentacioni i nevojshëm.

Kandidatët për drejtorë në Bordin e Drejtorëve, konform këtij konkursi, duhet t'i dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

• Aplikacionin (merret në zyrën e ndërmarrjes ose në ëeb faqe të ndërmarrjes, ëëë.kuzhina.net)

• CV-në

• Letër motivimin

• Dëshmitë mbi kualifikimin profesional të noterizuar (Diplomat/Certifikatat dhe dokumente të ngjashme të marra jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara).

• Dëshmitë mbi përvojën e punës e vërtetuar me trustin pensional (Aplikacioni duhet të ofroj të dhëna të sakta mbi periudhat e angazhimit dhe të korrespondojë me dokumentet vërtetuese).

• Certifikatën që nuk është nën hetime (jo me e vjetër se gjashtë muaj)

• Deklaratën nën betim (merret në zyrën e ndërmarrjes, ose në ëeb faqe të ndërmarrjes).

Me këtë dokument kandidati deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe ato të përshtatshmërisë profesionale sipas paragrafëve 1-3 të nenit 17 të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 03/L-087. Çdo përgënjeshttrim material - qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca - ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit.

• Kopjen e letërnjoftimit

• Lista kontrolluese (merret në zyrën e ndërmarrjes, ose në ueb faqe të ndërmarrjes).

5. Informata për procedurën e konkurimit.

Konkursi do të jetë i hapur nga data **15.03.2023** deri më datën **14.04.2023**; Dokumentacioni i aplikantëve mund të dorëzohet në arkivin e N.P.L. KUZHINA QENDRORE SH.A. në Prishtinë, çdo ditë pune prej orës 8:00 - 16:00, ose nëpërmes postes fizike; (në zarf të mbyllur) të adresuar: Për Komisionin Komunal të Aksionarëve të N.P.L. KUZHINA QENDRORE SH.A. Rr. Egnatia p.n. - 10 000 në Prishtinë - "Aplikacion për Drejtor Bordi".

Të gjitha dokumentet të paraqiten në kopje të noterizuara, ndërsa origjinali i tyre, do të kërkohet në fazat e më vonshme të përzgjedhjes. Informatat shtesë mund të sigurohen përmes e-mail adresës: kuzhinaqendrore@gmail.com, ose drejtpërdrejtë në arkivin e Ndërmarrjes. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren parasysh. Të gjithë formularët duhet plotësuar në tërësi, mos plotësimi i tyre dhe informatat e pasakta do të rezultojnë në diskualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit.

Komisioni Komunal i Aksionarëve do të zhvillojë një procedurë të hapur /transparente dhe konkurruese, ku përzgjedhja do të bëhet ekskluzivisht në bazë të meritës, konform Ligjit në fuqi dhe pa asnjë lloj diskriminimi, për çka inkurajon në aplikim kandidatët:

- nga gjinia femërore,

- kandidatët nga të gjitha komunitetet e Republikës së Kosovës; si dhe

-kandidatët nga të gjitha kategoritë tjera me pak të përfaqësuara në institucionet/organet/organizatat e vendit.

Komisioni i Aksionarëve Komunal të Ndërmarrjes Publike "Kuzhina Qendrore" Sh.A, Prishtinë:

, Kryesues Donat Lushaku

, Anëtar Dasmor Durmishi

, Anëtar Agim Kuleta



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




PASHTETË PULË

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pulë



cilësi e garantuar

pa konservues